REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1682 Rep.
Nr. 450 Kol.

KONTRATE SHITJE KUOTASH
Neni 23 i ligjit 7632 date 4.11.1992

Sot ne daten 12 Prill 1999 (nentedhjet e nente) u paraqiten personalisht para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne rrugen e Durresit, palet kontraktuese si vijon :

SHITESI : Z. Franco FRIGO, lindur me 13 Gusht 1950 dhe banues ne Cittadella ( PD) rruga S.Donato Nr.18, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporten Nr. 830657 F, i cili perfaqeson me prokuren Nr. Rep.52 818 date 17 Mars 1999 dhe Nr. Rep. 52.863 date 24 Mars 1999 Z. ing.Leonardo Antonio Cetera dhe Z. Rodolfo Cetera, me cilesine e keshilltarit Delegat dhe perfaqesuesit ligjir te Shoqerise " SILAC costruzioni s.r.l." me seli ne Padova.

BLERESI : Shoqeria "A.G.D." SHPK e perfaqesuar nga Z. Adrian Dulaku, i biri Nikos, lindur me 5 Shkurt 1960 dhe banues ne Tirane, ne Rrugen "Qemal Stafa" Pall.188, Ap.3, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporten Nr. AZ 096088.

Te dy palet me kerkuan redaktimin e shitblerjes kuotave qe vijon :

Ne baze te vendimit te Gjykates Rrethit Tiranes Nr. 531/P date 6-07-1994 eshte njohur person juridik Shoqeria " Edil Al It" SHPK me seli ne Tirane me ortaket : Shoqeria "A.G.D." Sh.P.K. me 40% te kuotave, Shoqeria "ZANON COSTRUZIONI" S.P.A.( me vone e emertuar "SILAC costruzioni" s.p.a., qe ka 47% te kuotave, Z. Leonardo Antonio, qe ka 3% te kuotave dhe Z. Franco Frigo, i cili ka 10% te kuotave.

Z. Franco FRIGO deklaron se gjithe kuotat e shoqerise "SILAC costruzioni" s.r.l. dhe kuotat e Z. Leonardo Antonio Cetera ja shet shoqerise " A.G.D., per te cilen deklaron se i blen perfaqesuesi i saj Z. Adrian Dulaku. Per blerjen e tyre bleresi i likujdoi shitesit shumen prej 50.000 (pesedhjet mije) leke, shume e cila u likujdua jashte zyres noterise.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale dhe me regjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tiranes, shitesit e humbasin çdo te drejte pronesie ne shoqerine "Edil Al It" SHPK dhe pronare te vetem te saj mbeten Shoqeria A.G.D. SHPK, qe ka 90% te kuotave dhe Z. Franco FRIGO qe ka 10% ne kete shoqeri.

Kopjes se kontrates qe do te qendroje ne Zyren e Noteris ne Tirane i bashkangjiten vendimi i Gjykates Rrethit Tiranes.

Sa me siper perpilohet nga une noterja kjo kontrate shitblerje kuotash, e cila ju lexohet paleve me ze , ne prezencen e perkthyeses Znj. Raimonda

Gjençaj,dhe mbasi gjendet konforme vullnetit te tyre te lire e te plote, e firmosin rregullisht ate, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITESI
Z.Leonardo Antonio Cetera
Shoq."Silac Costruzioni" s.r.l.,
perfaq. nga Z. Franco FRIGO

FRANCO FRIGO

BLERESI
Shoqeria "A.G.D."SHPK
e perfaq. nga Z.Adrian DULAKU

Adrian Dulaku

BULLE TAKSE
100 LEKE